- (c) Ne ofrojmë t'ë realizojmë për Autoritetit/Entit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), punimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në preventiv, me të gjitha projektet teknike, e me kërkesat në detyrën e projektimit apo termat e referencës, nëse është rasti, dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Vlerësimit;
 4. Kriteret e Përzgjedhjes;
 5. Specifikimet teknike, Projektet dhe çdo dokumentacion teknik;
 6. Preventivin e çmimeve
 7. Termat e referencës (nëse është rasti)
 8. Detyrën e projektimit (nëse është rasti)
 9. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 10. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

² Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë]

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** _____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa vlerë do të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Oferta ekonomike e detajuar

Nr	Nr. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësi	Sasia	Çmimi/ Njësi	Cmimi total
1.						
2.						
3.						
Shuma						
Fondi Rezervë						
Shuma						
TVSH						
SHUMA TOTAL						

Nënshkrimi i ofertuesit _____**Vula****Shënim:** Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

Shtojca 3.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet)*: Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e *[emri i autoritetit /entit kontraktor]* vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në *[njoftimin e kontratës]*.

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Të dhënat teknike të punëve objekt prokurimi duhet të përshkruhen sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

SHËNIM: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 6.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

GRAFIKUT I ZBATIMIT TË PUNIMEVE

Afatet e realizimit të punimeve: 4 muaj

Shënim. Autoriteti/enti kontraktor mund të shtojë rreshta në varësi të zërave të punimeve dhe kollona në varësi të afatit të parashikuar për realizimin e tyre.

Shtojca 7

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, oseqë ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*
- c. *Shtojca 1 Formular Oferte*
- d. *Shtojca 2 Liste cmimesh*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale :

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit (shtojca 7).

2.2 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2.a Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturas dhe Energjise, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008, të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme :

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

- **NP - 1 C** Punime gërmimi në tokë;
- **NP - 4 D** Rruge autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro pista aeroportuale
- **NP - 5 C** Punime nentoksore , ura e vepra arti
- **NP - 6 B** Diga dhe tunele hidroteknike
- **NP-11 B** Ndërtime për N/stac., kab. e transform. linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë
- **NP-12 C** Punimet të inxhinierisë së mjedisit

Për punimet speciale të ndërtimit:

- **NS-4 C** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik ,metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese
- **NS - 5 A** Impiante te sinjalistikes ndricuese te trafikut
- **NS - 6 A** Sinjalistika Rrugore jo ndricuese

- **NS - 7 A** Barriera dhe mbrojtje rrugore
- **NS- 8 B** Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri
- **NS - 9 B** Punime strukturore speciale
- **NS - 10 B** Shtresa dhe mbistruktura speciale
- **NS - 13 B** Impiante dhe linje telefonike dhe telekomunikacionit
- **NS – 14 B** Impiante të brëndëshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.
- **NS - 18B** Punime topogjeodezike

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës. Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

2.2.b Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B “ Grumbulim dhe transportim i mbetjeve inerte dhe dhera si mbetje te parrezikshme ” ,konkretisht kodet: 01 04 08 , 17 01 01, 17 05 04, 17 05 06, 17 05 08, 17 09 04 , 20 03 06 . Mbështetur në: Ligj Nr. 9010, date 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”(Ndryshuar me Ligjin Nr 10137, date 11.05.2009 “Per disa ndyshime ne legjislacionin ne fuqi per licensat,autorizimetdhe lejet ne Republiken e Shqiperise”)Kreu II N.9 N. 12 N. 24/1 N. 25.

2.2.c Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikata të vlefshme të lëshuara nga ente kombetare ose nderkombetare të akredituara, të përcaktuara si më poshtë:

- Certifikatë **ISO 9001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”
- Certifikatë **ISO 45001: 2018** mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë”
- Çertifikatë **ISO 14001:2015** mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”
- Çertifikatë **ISO 50001:2018** Per “Sistemin e menaxhimit te energjise”

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga ente kombetare ose nderkombetare të akredituara. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

2.3 Kapaciteti ekonomik dhe financiar :

2.3.1 Për të provuar kapacitetet ekonomike dhe financiare, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar.

2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2024 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2025.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit të BOE, duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2024 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2025, sipas të dhënave të QKB-së.

Shënim : Operatorët ekonomikë për përmbushjen e kësaj kërkesë duhet të vetëdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST, se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me percaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2023 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2024

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

2.4 Kapaciteti teknik:

2.4.1 Operatorët ekonomikë duhet të kenë përvojë të suksesshme në kontrata të mëparshme dhe për këtë duhet të paraqesin :

- a) dokumentacion për punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të ulët se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës;
- b) dokumentacion për punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e ulët se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

Për kontrata të realizuara me ente publike operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje;
- Leje Ndertimi
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore;
- Aktin e kolaudimit;
- Certifikaten e marrjes në dorezim të perkohshëm/perfundimtar.

Shënim : Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.

Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm :

- Formular vleresimi per realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Leje Ndertimi
 - Situacionin përfundimtar;
 - Faturat tatimore;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Certifikaten e marrjes ne dorezim te perkohshem/perfundimtar.
- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontraten e bashkimit të operatoreve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

3.Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik:

- a) Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë konkretisht si më poshtë :
- | | |
|--|----------|
| b) Inxhinier Ndertimi (Infrastuktur Transporti) | 1 (një) |
| c) Inxhinier Strukturist | 1 (një) |
| d) Inxhinier Elektrik | 1 (një) |
| e) Inxhinier Gjeomatik / Topograf | 1 (një) |
| f) Inxhinier Mjedisi | 1 (një) |
| g) Inxhinier Mekanik | 1 (një) |
| h) Inxhinier Hidroteknik | 1 (një) |
| i) Inxhinier Elektronik | 1 (një) |
| j) Arkitekt | 1(një) |

Shenim : VENDIM Nr.42, datë 16.1.2008 KREU IV Pika 2. Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike.

Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit.

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë pune, Diplomën Universitare, Libreze pune dhe Cv.
- Deklarate nga Operatori Ekonomik se Autoriteti Kontraktor gëzon të drejtën të bëjë kontrollin dhe verifikimin Për Drejtuesit teknikë të shoqërisë .

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve ekonomik, sipas punimeve që merr përsiper të realizojë referuar Preventivit të punimeve, secili Operator

duhet te përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin/t Teknik të punimeve në objekt, të cilët duhet të jetë të përfshirë në licencën e shoqërisë.

- k) Operatorët ekonomikë duhet të përcaktojnë me anë të një deklarate nga (Administratori i shoqërisë), Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe që do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve në kantier dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera. Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt, i deklaruar duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”
(Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkepunitimit).
4. Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/certifikuar si:
- a) 1 (nje) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatoreve ekonomikë, secili prej Operatoreve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (nje) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").
 - b) Inxhinieri Gjeomatik / Topograf I Certifikuar për Punime Kapitale Nentokesore për Infrastrukturë Rrugore , dhe objekte të Tjera me karakter Publik, Certifikate e lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”
 - c) Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1(nje) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatoreve ekonomikë, secili prej Operatoreve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin.
 - d) Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij Drejtues Teknik (Inxhinier Ndërtimi) **i certifikuar si Specialist Për Testimin e Performances së Materialeve/Produkteve të Ndërtimit /Inxhinier Materialelesh.**
 - Specialist Për Testimin e Performances së Materialeve/Produkteve të Ndërtimit /Inxhinier Materialelesh është përgjegjës për vlerësimin dhe testimin e materialeve dhe produkteve që përdoren në industrinë e ndërtimit për t'u siguruar që ato përmbushin standardet e kërkuara për sigurinë dhe cilësinë. Ky lloj specialisti duhet të ketë njohuri të thella në lidhje me metodat e testimit, standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe materialet që përdoren në ndërtim.

- e) 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave").
- f) Minimumi 1 (nje) person qe permbush kriteret per te qene “Vleresimi i ndikimit ne mjedis” lëshuar nga Ministria e mjedisit referuar Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS

Të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 Muaji e Fundit

4. Operatori ekonomik duhet të ketë një numër mesatar të punonjësve të siguruar jo më pak se **20 punonjës** të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për 3 Muajt e Fundit

Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a. Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore
- b. Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuesë ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 8, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

5. Operatorët ekonomikë për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë;

- Teknik ndertimi	1 (nje)
- Elektracist	1 (nje)
- Hekurkthyes	1 (nje)
- Hidraulik	1 (nje)
- Punonjes Asfalti	3 (Tre)
- Gurpunues	3 (Tre)
- Murator	1 (nje)
- Betonues	1 (nje)
- Eskavatorist	2 (dy)
- Automakinist	2 (dy)
- Buldozierist	2 (dy)
- Shofer	3 (Tre)

Për këta punonjes, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin :

- Kontratë individuale të punës;

- Një dokument (Diplomë/certifikate profesionale), që vërteton nivelin e kualifikimit profesional, lëshuar nga institucione publike/private, të licencuara/akredituara, të njohura nga Republika e Shqipërisë.
- Te figurojnë në listpagesa Muajt e fundit.
- Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e mesiperm, emer/mbiemer, profili i punës, numri dhe datë e kontratës individuale të punës, numri amzes dhe titulli i kualifikimit për diplomën përkatëse, si dhe institucionin që ka lëshuar këtë dokument.
- Ndërsa punonjësit e kualifikuar si (Eskavatorist, Automakinist dhe drejtues mjeti), të kërkuar sipas gërmës “a”, të cilët përveç se si pjesë të stafit të ofertuesit mund të jenë të kontraktuar.

Nuk do të njihen si dëshmi profesionale kurset e trajnimit të lëshuara nga subjektet të cilat nuk janë të licencuara/akredituara nga institucionet përkatëse për licensimin/akreditimin e tyre.

Per profesionet si me sipër, operatori ekonomik duhet të plotësojë tabelën si me poshtë:

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni i punojesit	Emri i Institucioni publik/privat lëshues i certifikates/diplomes	Numri indentifikues i certifikates/diplomes	Nr NIPT - (Ne rast se lëshuesi është institucion privat)
1					
2					
.....					

6. Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë për realizimin e kontratës mjetet teknike dhe mbrojtëse si më poshtë vijon;

Nr.	Mjete/pajisje teknike	Sasia	Gjendja
	Kamion (kapaciteti mbajtës mbi 20 ton)	2 copë	Në pronësi ose me qera
	Kamion (kapaciteti mbajtës mbi 10 ton-15 ton)	2 copë	Në pronësi ose me qera
	Kamiona vetëshkarkues me kapacitet mbajtës nga 8-10 ton me Vinc	2 copë	Në pronësi ose me qera
	Kamionçina me kapacitet mbajtës deri në 4-5 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Kamionçine (kapaciteti mbajtës 1.5 deri në 2 ton)	1 copë	Në pronësi ose me qera
	AutoBetoniere 2.5-3.5 m3 mjet teknologjik me goma	2 copë	Në pronësi ose me qera
	Asfaltoshtruese	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Grejder me goma mjet teknologjik me goma	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Autobitumatrice	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Dumper (mjet teknologjik me goma)	2 cope	Pronesi ose me qera
	Rul gome – hekur mbi 8-10 ton	1 cope	Pronesi ose me qera
	Rul asfalti hekur – hekur 1- 3 ton	1 cope	Pronesi ose me qera
	Rul hekur – hekur mbi 8 ton	1 cope	Pronesi ose me qera
	Koke terheqese	1 cope	Pronesi ose me qera
	Rimorkiator për transportin e makinerive	1 cope	Pronesi ose me qera
	Makineri Vijezi	1 cope	Në pronësi ose me qera
	Eskavator me Zinxhir	2 cope	Në pronësi ose me qera
	Autobot uji	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Autobetoniere	2 cope	Në pronësi ose me qera
	Autopompe betoni	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Autovinc me Kosh	2 copë	Në pronësi ose me qera
	Ekskavator me goma mjet teknologjik me goma	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Fadromë me goma	1 copë	Në pronësi ose me qera

	Mini Eksavator me zinxhir	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Pirun Ngrites	3 copë	Në pronësi ose me qera
	Elektrosaldatriçe	3 copë	Në pronësi ose me qera
	Matrapik	4 copë	Në pronësi ose me qera
	Moto gjenerator	2copë	Në pronësi ose me qera
	Depozite uji (kapaciteti minimal 2000 litra)	2 copë	Në pronësi ose me qera
	Betoniere kantieri	4 copë	Në pronësi ose me qera
	Depozite per Grumbullim materiale	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Tub Shkarkimi	30 ml	
	Deflektometer per shtresat e tokes	1 copë	Në pronësi ose me qera
	GPS	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Zyre Kantieri	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Instrument nivelimi (Teodolid)	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Vidator	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Troko	1 copë	Në pronësi ose me qera
	Tokomak ngjeshje dheu	4 copë	Në pronësi ose me qera
	Karroca	4 copë	Në pronësi ose me qera
	Nivelues Betoni	2 copë	Në pronësi ose me qera
	Pompe Suvatimi	4 copë	Në pronësi ose me qera
	Prerëse Pllakash	5 copë	Në pronësi ose me qera
	Përdaf Muratori	12 copë	Në pronësi ose me qera
	Pajisje P.P.E	10 copë	Në pronësi ose me qera
	Pompë lyerje	4 copë	Në pronësi ose me qera
	Vibrator Betoni	3 cope	Në pronësi ose me qera
	Pompë Uji	2copë	Në pronësi ose me qera
	Fikse Zjarri	20 copë	Në pronësi ose me qera
	Aparat Saldimi	2copë	Në pronësi ose me qera
	Aparat Testim Nyjesh	2copë	Në pronësi ose me qera
	Rrjetë Plastike	2000 m2	Në pronësi ose me qera
	Skeleri	1600 m2	Në pronësi ose me qera
	Betoforma	300 m2	Në pronësi ose me qera
	Fabrike Betoni jo me larg se 40 km (me planvendosje/genplan / certifikaten e kalibrimit) pajisur me QKL / mobile e levizeshme	1 cope	Pronesi, me qera ose aktmarreveshje furnizimi
	Fabrike Asfalti jo me larg se 40 km (me planvendosje/genplan / skema teknologjike/ raportet e vetmonitorimit 6 Muaji e fundit 2026) pajisur me QKL/ mobile e levizeshme	1 cope	Pronesi, me qera ose aktmarreveshje furnizimi
	Nyje prodhim Inertesh e pajisur me QKL	1 cope	Nyje prodhim Inertesh e pajisur me QKL

- **Pajisje të tjera ndihmëse, (të cilat duhet të vërtetohen me deklaratë sipas shtojcës perkatëse, të DST:**

Nr	Mjete mbrojtëse	njesia	sasia	statusi
1	Kokore	copë	30	Në pronesi ose me qera
2	Jelek	copë	30	Në pronesi ose me qera
3	Tabela Sigurimi Teknik	copë	30	Në pronësi ose me qera

4	Kuti Ndhime e shpejt	copë	15	Në pronësi ose me qera
5	Prozhektor për ndricim	copë	10	Në pronësi ose me qera
6	Çizme	copë	15	Në pronësi ose me qera
7	Doreza	copë	15	Në pronësi ose me qera
8	Kominoshe	copë	15	Në pronësi ose me qera
9	Lopat	copë	12	Në pronësi ose me qera

Makineritë dhe paisjet në pronësi të shoqërohen me akt pronësie original ose fotokopje e notuar.

- a) Makineritë dhe paisjet me qira të shoqërohen me kontrata qiraje si dhe të shoqërohen me aktin e pronësisë të qiradhënësit (orgjinal ose fotokopje e notuar).
- b) Kontrata e qirasë për makinerite në fjalë duhet të mbulojë afatin e përfundimit të zbatimit të punimeve që parashikon kontrata që prokurohet.
- c) Për mjetet që shënohen në regjistrat publik duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin (leje qarkullimi, akt kolaudimi, siguracion, leje transporti, foto). Për paisjet e tjera duhet të jenë aktet e zhdoganimit ose faturat e blerjes, orgjinale ose fotokopje e notuar.
- d) Autoriteti kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetesinë e deklarates dhe verifikimin e makinerive dhe pajisjeve në terren. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me nenin 13 pika 3 germa a të ligjit Nr.9643 date 20.11.2006 i ndyshuar "për prokurimin publik".
- e) Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. Për këtë të paraqitet "Deklaratë" nga administratori i shoqërisë ofertuese. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara.

Shënim: *Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.*

7. Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit.
8. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratën ku të shprehet se është dakord me mënyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të përfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor (në rast të shpalljes fitues).

9. Operatori ekonomik në rast se nuk është prodhues duhet të paraqesë kontratë e furnizimit materiale për materialet si më poshtë:

-
-
- a.Tombino betoni
 - b.Hekur
 - c.Gabione

10. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributor i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi noteriale të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave nënshkruar jo më parë se data e publikimit të procedurës së prokurimit. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, website, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.

Katalogun /et ose fragmente te katalogut/eve e prodhuesit /ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik

_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

PJESA I: A. INFORMACION NË LIDHJE ME OPERATORIN EKONOMIK

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ---

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik

(nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**



Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: SHKAQET E PËRJASHTIMIT

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p> ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p> kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

ifajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

ii

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se:

Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", të ndryshuar.

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër³.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

çmimet;
metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin;

³ Për qëllim të kësaj deklaratë dhe ofertës së paraqitur, fjala "konkurrentë" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA “Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës”

Deklarata

